

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA - GAP

PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

dhe

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

PËRMBAJTJA:

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR.....	2
INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA - GAP	4
PASQYRA E POZITËS FINANCIARE	4
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	5
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË TË GATSHME	6
1. HYRJE.....	7
2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE	7
3. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E SAJ	9
4. LLOGARITË E ARKËTUESHME	9
5. PAISJET E ZYRES.....	9
6. DETYRIMET TJERA.....	10
7. TE HYRAT E SHTYERA.....	10
8. TE HYRAT E ORGANIZATES.....	10
9. SHPENZIME TE PERSONELIT	10
10. SHPENZIME TE TJERA OPERATIVE.....	11
11. DETYRIME TE MUNDSHME DHE ANGAZHIME.....	11

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për: Menaxhmentin dhe bordin e INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA - GAP

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA - GAP ("Organizata"), të cilat përbëhen nga Pasqyra e Pozicionit Financiar me 31 dhjetor 2025, Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse, dhe pasqyra e Rrjedhës së Parasë për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të "INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA – GAP" më 31 dhjetor 2025 dhe performancën e tij financiare dhe rrjedhën e parasë së gatshme për vitin e përfunduar më datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe kërkesat e Ligjit Nr. 06 / L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, siç përcaktohet në Shënimin 2. të pasqyrave financiare.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare* e këtij raporti.

Ne jemi të pavarur nga organizata në pajtueshmëri me kërkesat etike që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike në pajtueshmëri me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e përftuara të auditimit janë të majftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në pajtueshmëri me dispozitat e raportimit financiar të organizatës dhe ligjeve relevante në Kosovë dhe për kontrole të tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë ose të ndërpresë aktivitetet e organizatës, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprojë në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të organizatës.

Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojme evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.
- Përftojme njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përftuar e auditimi, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e organizatës për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përfuara deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që organizata të mos vijojë aktivitetet e saj.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënës të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënës në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Lulzim Zeka
Auditor Ligjor



bakertilly
Baker Tilly Kosovo L.L.C.
Prishtinë

Baker Tilly Kosovo
10 mars 2026

**INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA - GAP
PASQYRA E POZITËS FINANCIARE**


Me 31 dhjetor 2025

(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)


		Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
	Shënime		
Asetet afatshkurtra			
Para dhe ekuivalentë të parasë	3	92,930	209,070
Llogari të arkëtueshme	4	-	11,620
Gjithsej		92,930	220,690
Paisjet e zyres	5	4,075	4,994
Gjithsej		4,075	4,994
Gjithsej asete		97,005	225,684
Detyrimet afatshkurtra			
Detyrime të tjera	6	3,854	4,689
Të hyrat e shtyera	7	93,151	220,995
Totali i detyrimeve afatshkurtra		97,005	225,684
Gjithsej detyrimet dhe fondet		97,005	225,684

Këto pasqyra financiare janë aprovuar dhe nënshkruar me 02 mars 2026 në emër të Menaxhmentit të organizatës:

Blendi Hasaj
Drejtor Ekzekutiv



Nita Tafarshiku
Menaxhere Financiare



Shënimet shoqëruese nga 7 deri në 11 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA - GAP
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE
Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025
(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

Për vitin që përfundon		Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
	Shënime		
Të hyrat e njohura	8	297,761	444,607
Gjithsej të hyrat		297,761	444,607
Shpenzimet			
Shpenzimet e personelit	9	(216,209)	(225,232)
Te tjera shpenzime operative	10	(79,473)	(217,407)
Shpenzimet e zhvlersimit	5	(2,079)	(1,967)
Gjithsej Shpenzimet		(297,761)	(444,607)
Tepricat / (Mungesat) e vitit		-	-

Shënimet shoqëruese nga 7 deri në 11 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA - GAP
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË TË GATSHME
Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025
(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

Për vitin që përfundon	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Fitimi (humbja) i/e vitit	-	-
Rregullimet për:		
Zhvlerësimet	2,079	1,967
Ndryshimi në parapagime	11,620	11,408
Ndryshimi në llogaritë e pagueshme	(835)	(1,388)
Ndryshimi në të ardhurat e shtyra	(127,844)	(66,623)
Rrjedha neto e parasë së gatshme nga aktivitetet operative	(114,980)	(54,635)
AKTIVITETET INVESTIVE		
Pagesat për blerje të prona, pajisje dhe impianteve	(1,160)	(2,951)
Rrjedha neto e parasë së gatshme nga aktivitetet Investuese	(1,160)	(2,951)
Rritja / (Zvogëlimi) i parasë nga aktivitetet	(116,140)	(57,586)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	209,070	266,655
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	92,930	209,070

Shënimet shoqëruese nga 7 deri në 11 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA - GAP SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

1. HYRJE

Instituti për Studime të Avancuara GAP (IASGAP) është një organizatë joqeveritare e regjistruar me numër regjistrimi 5111579-1. Organizata është regjistruar zyrtarisht më 17 gusht 2007 dhe operon në formën juridike të një Shoqate.

Adresa e regjistruar e organizatës është Rr. Sejdi Kryeziu 4/4, Prishtina, Prishtinë, Kosovë.
Të dhënat e kontaktit përfshijnë numrin e telefonit +383 38 224 145 dhe numrin mobil +383 44 130 582.
Adresa zyrtare e emailit është nita@institutigap.org.

Përfaqësuesi i autorizuar i organizatës është z. Blendi Hasaj, i cili shërben si Drejtor Ekzekutiv.

Themeluesit e organizatës janë znj. Argjentina Grazhdani, z. Astrit Isufi dhe z. Shpend Ahmeti.

Misioni dhe Aktivitetet

Misioni i institutit është të ngritë çështje në agjendën e politikave publike duke ofruar analiza të detajuara kërkimore mbi politikat publike. Organizata ofron vlerësime, opsione politike dhe rekomandime mbi çështje të politikave publike, promovon diskutimin publik mbi çështjet e politikave dhe ofron asistencë në zbatimin e politikave publike.

Organizata operon në fushën "Shoqëri për Shoqërinë", duke kontribuar në interesin publik dhe zhvillimin e politikave publike.

2. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1 Parimi i përgjithshëm i kontabilitetit

Organizata mban regjistrimet e saj kontabël mbi bazën e modifikuar të parasë (modified cash basis). Sipas kësaj metode, të hyrat regjistrohen kur pranohen paratë, ndërsa shpenzimet regjistrohen kur paguhen.

Modifikimet në bazën e parasë lidhen me llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme, të cilat njihen në fund të periudhës raportuese.

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e prezantimit

Pasqyrat financiare janë prezantuar në Euro (EUR), e cila është monedha funksionale e organizatës.

2.4 Tatimi mbi të ardhurat

Organizata është një organizatë joqeveritare (OJQ) dhe donacionet e pranuar gjatë vitit raportues janë përdorur për qëllime humanitare.

Sipas Ligjit nr. 06/L-105 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, OJQ-të të cilat përdorin të gjitha të ardhurat për qëllime të përfitimit publik janë të përjashtuara nga tatimi.

2.5 Prona, impiantet dhe pajisjet

Politika e organizatës është që prona, impiantet dhe pajisjet e blera për qëllime të projekteve të njihen si shpenzim, në përputhje me kërkesat e donatorëve.

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA - GAP

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

1. Deklarata e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.6 Para dhe ekuivalentë të parasë

Para dhe ekuivalentë të parasë përfshijnë paratë në arkë dhe paratë e depozituara në banka.

2.7 Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj regjistrohen sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit.

Asetet dhe detyrimet monetare të denominuara në valutë të huaj rillogariten sipas kursit të këmbimit në fund të periudhës raportuese.

Dallimet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga rillogaritja njihen në rezultatin financiar (fitim ose humbje).

2.8 Të hyrat

Të hyrat njihen në atë masë sa është e mundshme që përfitimet ekonomike të rrjedhin në organizatë dhe që të hyrat mund të maten në mënyrë të besueshme.

2.9 Shpenzimet

Shpenzimet përbëhen nga shpenzimet e programeve, administratës dhe menaxhimit.

Shpenzimet njihen në momentin kur ato ndodhin.

2.10 Llogaritë e pagueshme

Kontributet pensionale, tatimet mbi pagat dhe detyrime të tjera të akumuluar janë paraqitur në pasqyrat financiare si llogari të pagueshme.

2.11 Të ardhurat e shtyra

Të ardhurat e shtyra janë të ardhura/donacione për të cilat organizata ka pranuar pagesën, por që ende nuk janë shpenzuar.

Si rrjedhojë, kjo detyrim lind kur organizata pranon pagesë paraprake për një projekt që do të zbatohet në të ardhmen.

2.12 Deficiti i të hyrave mbi shpenzimet

Bilanci negativ (deficiti) është rezultat i donacioneve të pranuar dhe kostove të projekteve të zbatuara deri në fund të vitit.

2.13 Përfitimet e punonjësve

Organizata bën kontribute për përfitimin e punonjësve në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK). Kontributet njihen si shpenzim në momentin kur ato ndodhin.

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA - GAP
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025
(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

3. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E SAJ

Më 31 dhjetor	2025	2024
Para në bankë	92,843	208,938
Para në arkë	86	132
Gjithsej	92,930	209,070

4. LLOGARITË E ARKËTUESHME

Më 31 dhjetor	2025	2024
Të arkëtueshmet nga DEMOS	-	2,157
Të arkëtueshmet nga GLPS (Projekti i Ambasadës Britanike)	-	9,463
Gjithsej	-	11,620

5. PAISJET E ZYRES

<i>Kosto</i>	Paisjet e zyres	Total
Më 31 dhjetor 2023	16,634	16,634
Shtesat	2,951	2,951
Heqjet	-	-
Më 31 dhjetor 2024	19,584	19,584
Shtesat	1,160	1,160
Heqjet	-	-
Më 31 dhjetor 2025	20,745	20,745
<i>Zhvleresimi i akumuluar</i>		
Më 31 dhjetor 2023	(12,623)	(12,623)
Shpenzimet e amortizimit	(1,967)	(1,967)
Korrigjimi i zhvleresimit	-	-
Më 31 dhjetor 2024	(14,591)	(14,591)
Shpenzimet e amortizimit	(2,079)	(2,079)
Korrigjimi i zhvleresimit	-	-
Më 31 dhjetor 2025	(16,670)	(16,670)
<i>Vlera neto kontabel</i>		
Më 31 dhjetor 2024	4,994	4,994
Më 31 dhjetor 2025	4,075	4,075

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA - GAP
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025
(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

6. DETYRIMET TJERA

Më 31 dhjetor	2025	2024
Llogarite e pagueshme ndaj furnitoreve	1,070	1,388
Kontributi pensional i pagueshem	1,506	1,816
Tatimi i mbajtur ne burim ne te ardhurat personale	1,170	1,377
Tatimi ne qira (WR)	109	109
Gjithsej	3,854	4,689

7. TE HYRAT E SHTYERA

Më 31 dhjetor	2025	2024
Të hyrat e shtyera	93,151	220,995
Gjithsej	93,151	220,995

8. TE HYRAT E ORGANIZATES

Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor	2025	2024
Rockefeller Brothers Fund	61,585	26,221
Fondacioni i Kosoves per Shoqeri te Hapur (KFOS)	48,265	106,600
Fondacioni i Shoqerise Civile ne Kosove (KCSF)	39,200	-
Ambasada Britanike	12,538	64,900
Fondi per Zhvillim te Komunitetit (CDF)	11,207	66,683
Demos	8,843	45,587
SMART	1,211	3,186
Agjencia Suedeze per Bashkepunim Nderkombetar dhe Zhvillim (Sida)	-	106,351
Programi i Kombeve te Bashkuara per Zhvillim (UNDP)	-	15,698
Te hyra te tjera	114,912	9,381
Gjithsej	297,761	444,607

9. SHPENZIME TE PERSONELIT

Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor	2025	2024
Shpenzimet e personelit	216,209	225,232
Gjithsej	216,209	225,232

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA - GAP SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

10. SHPENZIME TE TJERA OPERATIVE

Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor	2025	2024
Shpenzimet e qirase	14,505	14,505
Shpenzimet e planifikimit dhe dizajnit	8,070	10,670
Shpenzimet e shërbimeve kërkimore	7,350	11,440
Mirembajtja e zyres dhe faqes se internetit	5,694	6,726
Media / reklamim	3,350	9,677
Shpenzimet e printimit	2,502	2,490
Shpenzimet profesionale	2,200	91,829
Shpenzimet e udhëtimit	2,104	12,205
Shpenzimet për pajisje zyre	2,017	2,588
Shpenzimet e komunalive	1,615	1,624
Shërbime përkthimi	1,471	7,019
Shpenzimet e komunikimit	1,159	2,044
Shërbime për takime të projektit	967	1,983
Shërbime bankare	506	896
Shpenzimet e gazetave	120	513
Shpenzime të tjera	25,843	41,198
Gjithsej	79,473	217,407

11. DETYRIME TE MUNDSHME DHE ANGAZHIME

Çështje ligjore

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024, organizata nuk ka qenë e përfshirë në asnjë çështje ligjore.

Ngjarje të mëvonshme

Nuk ka ndodhi pas datës së autorizimit të pasqyrave financiare që kërkojnë rregullime ose zbulime në pasqyrat financiare.